



DATË/A:	06.04.2022
PËR/ZA/TO:	z. Lendrit Cana, Drejtor i Kompanisë LC Group SH.P.K., Rr. Ali Sokoli, Rahovec me nr.unik 811592121
Kopje/Copy/	Arkiva e Komunës z. Durim Halilaj, Drejtor për Buxhete dhe Financa - Komuna Gjakovës z. Shefqet Dinaj, Menaxher i kontratës së AK z. Zymber Berisha, Mbikqyrës i Menaxherit të kontratës së AK
PËRMES /PREKO/THROUGH	z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Faton Gutaj, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informim për shkëputjen e kontratës me numër të prokurimit 632-21-8137-1-3-6 dhe nr.brendshëm 632-21- 131-136 "Furnizim me material ndertimor për klasen verore SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan"-Ritender

I/E nderuar/a,

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 22.11.2021, me numër të prokurimit 632-21-8137-1-3-6 dhe nr.brendshëm 632-21-131-136, "Furnizim me material ndertimor për klasen verore SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan"-Ritender, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe furnizuesit "LC Group SH.P.K., prej datës 07.04.2022, **NDËRPRITET**, duke u bazuar në nenin 28, paragrafi 28.1 nën a), b) dhe c) të kontratës dhe kërkesës nga menaxheri i kontratës, të dt.01.04.2022, për shkëputje të kontratës .

Disa here keni marrë urdhëresë nga Menaxheri i Kontratës z.Shefqet Dinaj, për realizimin e furnizimeve- puneve, konformë kushteve të kontratës dhe nuk jeni përgjigjur.

Gjithashtu Menaxheri i Kontratës z.Shefqet Dinaj, përmes komunikimeve zyrtare e-mailave, shkresave disa herë ju ka tërhequr vërejtjen se nëse nuk filloni me realizimin e kontratës do të kërkohet shkëputja e saj nga Zyra e Prokurimit(vërejtjet e dt.13.01.2022, 14.01.2022 dhe 11.03.2022), mirëpo përkundër vërejtjeve të shumta, Ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim e kualitetit dhe dinamikës për realizimin e furnizimeve- punëve.

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar këtë aktivitet të prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 07.04.2021, do të ndërmarrim të gjitha veprimet konforme kushteve të kontratës .

Shkresës i bashkëngjiten të gjitha komunikimet e deritanishme dhe dëshmitë e mos realizimit të kontratës.

Me respekt,



DATE:	01.04.2022
REFERENC-Ë:	04 nr.
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Gutaj, Shef i Zyrës së Prokurimit
CC:	- Z. Zymber Berisha, Udhëheqës i Sektorit të Arsimit, Gjakovë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Zymber Berisha
NGA/OD/FROM	Shefqet Dinaj , Menaxher i Projektit 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për shkëputje të kontratës "Furnizim me material ndërtimor për klasën verore SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan"-Ritender ,Nr. i kontratës 632-21-8137-1-3-6/C490, nr. 632-21-8137-1-3-6 dhe numrin e brendshëm 632-21-131-136

Të nderuar ,

Lidhur me Kontratën me Titull "Furnizim me material ndërtimor për klasën verore SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan"-Ritender , nr. 632-21-8137-1-3-6 , e lidhur në mes të Komunës së Gjakovës dhe LC Group SH.P.K. ,Rr. Ali Sokoli, Rahovec, me numër unik 811592121, e përfaqësuar nga Z. Lendrit Cana datë 22.11.2021, ju njoftojmë se:

Edhe përkundër kontratës pasi i njëjti ka patur Planin dinamik për 3 javë nga fillimi i punimeve të parapara deri te përfundimi i punës (24.11.2021 fillimi deri me 15.12.2021 përfundimi), vetëm ka filluar punimet me hapjen e 4 gropave për ngritjen e shtyllave të betonit, në të cilat u vendos edhe armatura e skeletit fi 12 dhe u bë mbushja e atyre gropave me beton nga kontraktori. (shih shkresa zyrtare nga unë si menaxher Sh. Dinaj e datës 13.01.2022).

Pastaj shkresa tjetër zyrtare " Vërejtje e fundit para shkëputjes së kontratës" për mos zhvillimin dhe përfundimin e punëve nga kontratuesi i lartëpërmendur u bë me datën 14.01.2022.

Shkresa e fundit zyrtare " **VËREJTJA E FUNDIT**" para shkëputjes së kontratës, drejtuar kontraktuesit LC Group, me përfaqësues z. Lendrit Cana, me seli në Rahovec u adresua me datën 11.03.2022, me q'rast ju dha edhe 5 ditë afat kohorë për përfundimin e punëve të filluara. (deri me 18.03.2022).

Kontraktuesi as sot e asaj dit nuk u paraqit në vend punim dhe nuk e realizoi kryerjen e punimeve të parapara me kontratën e lartëcekur.

KËRKESE!

Kërkojmë nga Zyra e Prokurimit- Gjakovë, fillimin e procedurave për ndërprerjen e kësaj kontrate.

Në Skivjan

Me: 01.04.2022



Menaxheri i kontratës- drejtori:

Dr.sc. Shefqet Dinaj

e-mail. shefqetdinaj@gmail.com

nr.tel. +383 44 269 919

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Shefqet Dinaj", written over a horizontal line.



Shefqet Dinaj <shefqetdinaj@gmail.com>

Njoftim!

1 message

Shefqet Dinaj <shefqetdinaj@gmail.com>

To: logroup.tex@gmail.com

Thu, Jan 13, 2022 at 3:45 PM

Përsëritje i nderuari Lendrit Cana!

KOMUNA E GJAKOVËS (në vazhdim "Autoriteti kontraktues"), në njëren anë, dhe LC Group SH.P.K., Rr. Ali Sokoli, Rahovec me numër unik 811592121, e përfaqësuar nga z. Lendrit Cana, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë. Furnizim me material ndërtimor për klasën verore SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan, -Ritender me numër identifikues si në kontratë. Pas vizitës në vend ngjarje të z. Mizair Cana dhe dakordimit për realizimin dhe ndërtimin e klasës verore, filloj edhe ndërtimi sipas kontrates dhe marrëveshjes sonë. Puna u zhvillua për një gjysëm dite, nga ju, ku u hapen 4 gropa për ngritjen e shtyllave të betonit, në të cilat u vendos edhe armatura e skeletit fi 12 dhe u bë mbushja e atyre gropave me beton nga ju.

Pas asaj pasdite, unë si menaxher i prokurimit për realizimin e këtij projekti, kam kontaktuar disa herë me telefon me z. Mizair Cana dhe kom kerkuar nga i njeiti që të vazhdoj punimet e filluara. Z. Cana gjithmonë mu ka përgjigjur ne telefon pozitivisht duke më premtuar se të nesërmen ose të pasnesërmen do të vijë me ekipë për ta ndërtuar dhe përfunduar klasën verore.

Meqë ka kaluar çdo limit kohorë, sepse data e fillimit të punës ishte 24.11.2021 ndersa afati i përmblotjes së punëve 15.12.2021, jam i detyruar që të njoftoj se keni afat edhe 3 (tri) ditë nga dita e nesërme që ta përfundoni punën e nisur, në të kundërtën detyrohem të ndermarr hapa tjerë procedurial deri në shkëputje të kontratës.

Gjithë të mirat,

Dr.sc. Shefqet Dinaj, menaxher i kontratë





Shefqet Dinaj <shefqetdinaj@gmail.com>

Vërejtje e fundit para shkëputjes së kontratës

1 message

Shefqet Dinaj <shefqetdinaj@gmail.com>

To: lcgrouptex@gmail.com

Cc: faton.gutaj@rks-gov.net, venera.shtaloja@rks-gov.net, eranda.baci@rks-gov.net

Fri, Jan 14, 2022 at 6:56 PM

Përshëndetje!

Në bashkëlidhje po ju dergoj vërejtjen e fundit para shkëputjes së kontratës me Operatorin Ekonomik LC Group SH.P.K. përfaqësuar nga Z. Lendrit Cana, Rahovec, lidhur me projektin: "Furnizim me material ndermisor për klasen verore SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan".

Gjithë të mirat,

Dr.sc. Shefqet Dinaj,
drejtor i SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan, Gjakovë.

 **Vërejtje e fundit para shkëputjes së kontratës.docx**

13K

VËREJTJE E FUNDIT PARA SHKËPUTJES SË KONTRATËS

Në takimin e thirrur me datë 14.01.2022 në ora 9:00, ju kemi pritur, nuk keni marr pjesë dhe me propozimin nga ana juaj e shtymë takimin për në ora 13:30, por prap nuk keni marrë pjesë në takim.

Përfundim:

Ju keni afat tri (3) ditë d.m.th. deri me datë 20.01.2022 që të kryeni realizimin dhe përfundoni pozicionet sipas kontratës që keni pranuar dhe nënshkruar!

Pas datës 20.01.2022 nëse nuk përfundoni realizimin e kontratës, i propozoj Zyrës së Prokurimit fillimin e procedurave për shkëputje të kontratës.



Drejtori-Menaxheri:

Dr.sc. Shëfqet Dinaj



Shëfëqet Dinaj <shëfëqetdinaj@gmail.com>

Vërejtja e fundit!

1 message

Shëfëqet Dinaj <shëfëqetdinaj@gmail.com>

To: lcgroup.tex@gmail.com

Fri, Mar 11, 2022 at 11:05 AM

Përshëndetje i nderuar Lendrit Cana,

Po ju drejtohem për të tretën herë me shkrim, (pas komunikimit të disa herave me telefon me Z. Mizair Cana), për ta realizuar dhe përfunduar pozicionet sipas kontratës që keni pranuar dhe nënshkruar me Zyrën e Prokurimit të Komunës së Gjakovës për SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan.

Ju keni afat edhe 5 ditë dmth deri me datën 18 Mars 2022 që ta përfundoni punën sipas kontratës së nënshkruar nga ju!

Pas datës 18.03.2022 nëse nuk përfundoni realizimin e kontratës, i propozoj Zyrës së Prokurimit fillimin e procedurave për shkëputje të kontratës!.

Skivjan, 11.03.2022

Drejtori-Menaxheri: Dr.sc. Shëfëqet Dinaj

